

st
10.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR KORÇË
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR KORÇË-PUSTEC

Nr. 308/I Prot

Korçë, më 05.10.2021

Lënda: Shpallje E Procedurave Të Konkurrimit Për Drejtues Në Shkollën e Mesme Artistike "Tefta Tashko Koço" Korçë

Në mbështetje të Ligjit 69/2012 datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, , Urdhrit të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë me Nr 31 datë 28.01.2020 "Për Miratimin e Rregullores për Funkcionimin e Institucioneve Arsimore" "Për miratimin e Dispozitave Normative për Sistemin Arsimor Parauniversitar", Udhëzimit Nr 30 datë 12.09.2018 "Për numrin e nxënësve në klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar" kreut I, gërma A, pika 2 e Udhëzimit Nr.2 datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar"

Shpallen procedurat e konkurrimit për pozicionin drejtues Në Shkollën e Mesme Artistike "Tefta Tashko Koço" Korçë

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për të aplikuar për pozicionin drejtues institucioni arsimor :

- Të ketë fituar diplomë të ciklit të dytë në fushën e edukimit ose diplomë të njëvlershme me të sipas përcaktimeve të ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".
- Të ketë të paktën kategorinë "Mësues i kualifikuar"
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- Të kenë kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në shkollën e Drejtorëve për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe të jetë certifikuar pas hyrjes në fuqi të pikës 2 të nenit 55 të ligjit nr.69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

Dokumentacioni i aplikimit për pozicionin drejtues institucioni arsimor:

- Jetëshkrimin dhe kopjet e njësuara me origjinalin të dokumentave që dëshmojnë pohimet në të (sipas modelit të shtojcës 1/Udhëzimi Nr.2 datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar).
- Kopje e njësuar me origjinalin e librezës së punës(e noterizuar)
- Kopje e dokumentit të identifikimit (ID).

- Tabelën me të dhënat për aplikantin (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr 4 të Udhëzimit).
- Certifikatën e drejtuesit të institucionit arsimor pas zhvillimit të trajnimit të detyrueshëm përgatitor në shkollën e drejtorëve, për drejtimin e institucionit arsimor të arsimit parauniversitar).
- Vetëdeklarim i gjendjes gjyqësore (sipas shtojcës nr 2 bashkëlidhur udhëzimit)
- Vërtetim nga institucioni ku punon se aplikanti nuka ka masë disiplinore në fuqi.
- Deklaratën e mungesës së konfliktit të interesit të aplikantit me punonjësit arsimorë të institucionit arsimor, ku po konkurren për pozicioni drejtues (bashkëshort/bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prind të bashkëshortit/es) (sipas shtojcës nr 3 bashkëlidhur udhëzimit).

Aplikanti për drejtues institucioni arsimor duhet të paraqesë ZVAP Korçë-Pustec, brenda datës 15.10.2021 dosjen personale me dokumentacionin e poshtëshënuar me anë shërbimit postar:

Të respektohet afati i dorëzimit të dokumentacionit pranë ZVAP. Ky afat është taksativ.

DREJTOR

